

MBROJTJA E SHQIPES DHE SHTIMI I KULTURËS GJUHËSORE SI DUKURI MË VLERË TË PËRHERSHME KOMBËTARE

Njësimi i shqipes, krijimi dhe zbatimi i standardit të të shkruarit shqip në mbarë praktikën shkrimore e kumtuese shtetërore e publike ka qenë dhe mbetet fitore e madhe e popullit dhe e kombit shqiptar. Të folurit dhe, sidomos, të shkruarit në gjuhën letrare kombëtare ka qenë, **është dhe do të jetë kurdoherë** shenjë dhe tregues kulture. “Gjuha letrare është synim i përhershëm i njeriut tonë, sidomos i të rinjve të shkolluar e të profilizuar thellë e ethshëm në shkencën, artin e dijet bashkëkohore, prandaj edhe përbën një dukuri reale e që s’është as thjesht punë gjuhësie, as thjesht objekt kundrimi vetëm për gjuhëtarët.”⁽¹⁾ Ajo është një anë themelore e jetës shqiptare që, medoemos, duhet pasqyruar sa më gjerë edhe në studimet sociolinguistike. Puna është që kjo gjuhë e shkruar, në formën e vet më të përpunuar e të zhvilluar që ka mbërritur, edhe të ruhet, të jetë përherë në kujdesin e të gjithë shkruesve, botuesve dhe folësve në situata e mjedise zyrtare e publike.

Më 21 shkurt, në ditën ndërkombëtare të gjuhëve amtare, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, në **Kryeministrinë e Republikës së Shqipërisë**, organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “Sfidat e shqipes sot”. Në këtë tubim shkencor e studimor morën pjesë mësimdhënës dhe studiues të ftuar nga të gjitha universitetet shqiptare të Shqipërisë (nga Departamenti i Gjuhës Shqipe i Fakultetit Histori Filologji, nga Universiteti i Shkodrës, Korçës, i Durrësit, i Gjirokastrës, i Vlorës), si dhe nga universitete të Kosovës (nga Universiteti i Prishtinës, nga Universiteti i Prizrenit, nga Universiteti i Gjakovës), nga Universiteti i Shkupit, si dhe nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë Albanologjike të Tiranës dhe Shoqata e Gjuhës Shqipe.

¹ Ajeti I. Mjetet e informimit për ngritjen e kulturës gjuhësore, në “Çështje të kulturës së gjuhës”, Prishtinë, 1980, f.15; Raka F. Çështje të shqipes letrare, Shkup, 1998.

Tryeza e rrumbullakët “Sfidat e shqipës sot” kishte synim shqyrtimin dhe rrahjen e mendimeve për një qerthull problemesh e dukurish të shqipës, të nyjtuara në një parashtrësë në formë pikash a problemesh, si më poshtë:

- a. **Shqipja dhe globalizimi**, hapësira dhe kufij të nevojshëm, duke pasur në qendër të vëmendjes trysnimin e shqipës nga gjuhët e vendeve më të mëdha të Evropës e sidomos nga anglishtja, në kuadrin e marrëdhënieve dhe shkëmbimeve të sotme me popujt dhe kulturat e ndryshme e me mundësitë e takimeve dhe shkëmbimeve të lira nëpërmjet lëvizjes së lirë të njerëzve e të prodhimitarisë shkrimore e ligjërimore të folur. Pikat që merituan vëmendje ishin ato që edhe më parë kanë pasur interesimin e studiuesve të gjuhës shqipe e pikërisht: **huazimet e nevojshme**, ndërkombëtarizmat dhe barbarizmat; kalket leksikore dhe kalket sintaksore e strukturore; onomastika e huaj (emrat e personave dhe të vendeve) dhe drejtshkrimi i tyre në shqip.
- b. **Realiteti virtual, teknologjia, ndikimi i medias në gjuhë**, duke sjellë në vëmendje kundrimin e prurjeve dhe dukurive të një vargu elementesh të reja, por tashmë shumë aktive e të përhapura, siç janë portalet zyrtare; faqet ueb të institucioneve publike on-line; rrjetet sociale me karakter zyrtar ose publik; aplikacionet në telefoninë celulare; reklamat dhe mbishkrimet qytetëse e ndërqytetëse etj.
- c. **Gjuha në administratën shtetërore** dhe në botimet e institucioneve publike dhe jopublike me karakter zyrtar, duke kundruar pikat që lidhen me gjendjen dhe mundësitë e shtimit të kujdesit për disa prej treguesve të hershëm e të përherëshëm të burokracisë zyrtare shtetërore e publike, si: komunikimi shkresor ndërinstitutional dhe qasja e gjuhës së institucionit ndaj publikut, përmes komunikimit fizik shkresor dhe elektronik.
- d. **Gjuha dhe shkolla**, si njëri nga treguesit më të rëndësishëm e si të themi tradicional, i nyjtuar në kundrimet e dukurive të tilla kryesore, si: arsimit parauniversitar (tekstet shkolllore, detyrat dhe përgjegjësia e autorëve të

teksteve) dhe probleme të gjuhës shqipe në shkollën e lartë në përgjithësi dhe të detyrave të fakulteteve filologjike dhe atyre të edukimit, ku përgatiten mësuesit e ardhshëm të gjuhës shqipe.

- e. **Roli i mediave dëgjimore-pamore (audio-vizive) në politikat kombëtare për gjuhën**, me përparësinë e duhur për disa prej dukurive që kanë qenë edhe më parë, por që kanë fituar përhapje e fuqi ndikuese në kohën e sotme, si: gjendja e kulturës së gjuhës shqipe në emisionet radio-televizive; roli i folësve dhe i drejtuesve të emisioneve radio-televizive si dhe emisionet për gjuhën shqipe në radio-televizionet shqiptare.
- f. **Shtirja e standardizimit të gjuhës në të gjitha trojet shqiptare ballkanike dhe në diasporat shqiptare**, duke u pykëzuar në drejtimit më të rëndësishme të tilla, si: puna që duhet të bëhet për njohjen e veprave kodifikuese në shkallë mbarëkombëtare; botimet e veprave madhore e me rëndësi kombëtare, si fjalorët shpjegues normativë dhe krahinorë; gramatika të shqipes së sotme; hartimi dhe përmirësimi i librave shkollorë, që nga abetarja e më tej deri në tekstet universitare dhe botimet akademike.
- g. **Shqipja e sotme si gjuhë e përkthimeve dhe e letërsisë artistike**, duke u pykëzuar në dukuri dhe drejtime të tilla pune, si: shqipja dhe përkthimet e sotme letrare, politiko-shoqërore, teknike etj.; përkthimi i filmave artistikë dhe i filmave shkencorë; roli i platformave satelitore për gjuhën e filmave dhe realizimeve origjinale; botimet cilësore të letërsisë artistike (shkrimtarëve të njohur), si bazë e përpunimit sintaksor dhe e shijeve të mira për leksikun dhe frazeologjinë e shqipes; shqipja si gjuhë e dytë për të huajt.

Në këtë tubim, të cilin pata detyrën ta drejtoja, si në referatin e mbajtur prej meje, ashtu edhe në kumtimet e diskutimet e pjesëmarrësve, u theksua se ka ardhur koha të tregojmë më shumë kujdes për gjuhën shqipe si tipar themelor i njësisë dhe i njësimi kulturor e kombëtar, për gjuhën zyrtare të shtetit e të shkollës, natyrisht edhe të të gjitha institucioneve, që varen ose lejohen nga shteti. Të gjithë jemi dëshmitarë se sot shkollarët dhe

pasuniversitarët janë të interesuar dhe, madje, të drithëruar për dhënien provim e pajisjen me dëshminë e njohjes së anglishtes, pra për “Toeflin” ose dëshmi të njohshme e të pranueshme si pjesë e dosjeve a CV-së, por askush nuk shqetësohet për gjendjen jashtëzakonisht të pamirë të shqipes së shkruar e të folur në zyrat e shtetit, në universitetet publike e private e kudo. Dhe, kjo situatë do të vazhdojë nëse nuk do të kemi edhe ne zyrtarisht kërkesën me ligj të provimit dhe njohjes së gjuhës shqipe si kusht për të pasur një vend të caktuar në administratë (vendore apo qendrore).

Dhe, për të ardhur te thelbi i parashtrësës sime, mendoj se, një nga pikat më të rëndësishme të ecjes sonë të mëtejshme, midis globalizmit dhe kombëtarizmit gjuhësor është kultura e gjuhës, natyrisht e kuptuar ajo në vështrimin e sfidave të mëdha që ka sot krejt shqipja e shqiptaria në epokën e ecjes sonë përpara si komb e si popull.

Edhe në atë tubim studimor e kulturor, ashtu si dhe herë të tjera, u fol edhe për *domosdoshmërinë e një ligji për gjuhën zyrtare shqipe*.

Kemi folur e shkruar dhe gati masivisht pranohet se është e domosdoshme të tregojmë kujdesin e duhur ndaj gjuhës së shkruar në përdorimet zyrtare, në zyrat e shtetit e në krejt praktikën shkrimore të vendit, duke qenë të bindur se kjo, ndërkaq, jep dorë edhe për mbajtjen gjallë e shprehjen e njësisë kombëtare edhe në trevat shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë. Këtë të gjithë e pranojnë, por koha kalon dhe janë të pakta qëndrimet aktive, veprimet konkrete për ta shëndoshur gjendjen. Natyrisht, duhet edhe ligji për gjuhën zyrtare, ashtu si duhen edhe urdhëresat e nevojshme nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministritë e tjera, por një punë e mirë mund të bëhet edhe me nisma e veprime konkrete, sidomos nga universitetet. Rasti e kërkon që ta pohoj edhe një herë shembullin shumë të mirë që ka dhënë e po jep Albanian University, ku lënda “Gjuha shqipe standarde”, qysh nga krijimi i tij, jepet në degë të ndryshme, si në degën e Anglishtes, të Dizajnit etj., në Tiranë dhe në filialet e rretheve. Dhe kështu duhet të veprojnë edhe universitetet e tjera, derisa të mbërrijmë të kemi njohje dhe zbatim të mirë të rregullave të drejtshkrimit dhe të normave të

tjera të shqipes së njësuar. ⁽²⁾

Ruajtja dhe mbrojtja e gjuhës amtare ka qenë dhe do të vijojë, në jetë të jetëve, pjesë themelore e vlerave kulturore kombëtare

“Kujdesi për shqipen e shkruar e të folur në institucionet shtetërore e publike dhe në mediat e shkruara e elektronike, si dhe masat e nevojshme për rritjen e kulturës gjuhësore në universitetet shqiptare, nuk janë as punë gjuhësie, as punë vetëm e fakulteteve në të cilat lëndët gjuhësore janë bazë e formimit profesional. Kjo ka pasur dhe ka shumë rëndësi, por gjuha shqipe e njësuar dhe puna për ruajtjen e zbatimin e përpiktë e të vazhdueshëm, duhet të jetë pjesë e krejt formimit shkollor gjatë arsimit të mesëm, por, sipas rasteve, edhe në shkollat e larta, sepse ruajtja dhe mbrojtja e gjuhës amtare ka qenë dhe do të jetë në jetë të jetëve pjesë themelore e vlerave kulturore kombëtare.”⁽³⁾

Koha e sotme dhe ecja përpara e Shqipërisë dhe e shqiptarëve kërkon që ata të nxënë sa më mirë anglishten dhe gjuhët e huaja të tjera, por të ndjekim shembullin e Francës dhe të vendeve të tjera të Evropës së qytetëruar, që punojnë me përkushtim e me ligje të rrepta për mbrojtjen e gjuhës.

“Sot Shqipëria është një vend i hapur, ka një shtet që mban marrëdhënie me të gjithë botën dhe populli ynë është tashmë në lidhje e takime të drejtpërdrejta e që shkon e vjen me njerëzit e vet e me miq të shumtë në botë. Me fjalë të tjera, jemi bërë një shoqëri e hapur. *Edhe gjuha shqipe është e do të jetë edhe më tej “gjuhë e hapur”, ka marrë dhe do të marrë edhe më tej hua nga gjuhët e mëdha të Evropës, po edhe do të përtëritet nga gurrat vetjake.* Kemi parasysh sidomos prurjet e mirëpritshme të elementit verior e verilindor gjatë dhe pas shndërrimeve në Kosovë e në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.”⁽⁴⁾

“Ka shumë libra, shumë autorë tekstesh, por mungon cilësia, mungon të shkruarit me kujdesin e me kohën e nevojshme. Tekstet duhen ideuar, hartuar e redaktuar pa u ngutur, pa u ngashënjyer nga rendja pas fitimit të shpejtë të tenderit. E theksoj: tekstet duhet të kenë redaktor dhe korrektor gjuhësor shumë cilësor e të

² Po aty

³ Çeliku M., Çështje të shqipes standarde, Tiranë, 2001;Islamaj Sh., Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i gjuhës, Prishtinë, 2002.

⁴ Po aty

sprovuar. Të ketë kërkesa të rrepta për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar në të gjithë praktikën shkrimore e botuese, në mediat e shkruara dhe botimet shkencore, letrare etj., dhe të shtohet kujdesi edhe për ligjërimin e folur në mjediset publike e për funksionet zyrtare.”

Të ndjekim shembullin e Francës dhe të vendeve të tjera të Evropës së qytetëruar, të cilat punojnë shumë për mbrojtjen e gjuhës amtare si tipar i përbashkësisë dhe i njëjtësisë së kombit. Rregullat e drejtshkrimit dhe normat e shqipes standarde duhen parë gjithmonë si pronë kombëtare dhe karakteri kombëtar i tyre duhet ruajtur e pasur gjithmonë parasysht.

Shtetit shqiptar, sidomos Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe shkollave shqiptare, që nga fillorja e deri në universitet, u bie detyra që me anën e teksteve shkollore sa më të mira ta ushqejnë e ta gjallërojnë edhe më shumë këtë ndjenjë të shqiptarëve tekdo që gjenden në Evropë e në mbarë rruzullin.

Jemi të vonuar, por më mirë vonë se kurrë, të ideojmë, të veprojmë dhe të jetësojmë ngritjen e një shoqate të autoritetshme kombëtare për mbrojtjen e gjuhës shqipe, sikundër është p. sh. *“Défence de la langue Française”* (Mbrojtja e gjuhës frënge) dhe, e cila, në revistën e saj ka edhe artikuj të tillë, që qysh nga titujt tregojnë se sa kujdes bëhet atje për gjuhën: *“L’Académie Française, gardienne de la langue”* (Akademia Franceze – roje e gjuhës) ose *“Défence du français chez les jurists”* (Mbrojtja e frëngjishtes nga juristët).⁵

Kemi kërkuar dhe po e përsërisim se, gjuha shqipe, së paku për një periudhë kohore derisa të përmirësohet dukshëm cilësia e mësimdhënies së shqipes në arsimin parauniversitar, duhet të jetë lëndë mësimore edhe në universitetet, së paku për një periudhë të caktuar, derisa të mbërrihet një përgatitje më e mirë e nxënësve në shkollat e mesme. Gjuha shqipe e standardizuar u shërben sot edhe shqiptarëve në trojet e tyre ballkanike jashtë kufijve të shtetit shqiptar? Për këtë në kohët e sotme po zhvillohen shumë debate.

Sot kjo gjuhë shqipe, ky standard apo *shqipja zyrtare e njësuar po u shërben shqiptarëve në botë për t’i përbashkuar me njëritjetrin*. Sot një pjesë e madhe shqiptarësh jetojnë edhe në vende

⁵ Shkurtaç.Gj., Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës, Kristalina KH, Tiranë, 2003; Si të shkruajmë shqip-Baza të shkrimit akademik, Botimet Morava, 2013.

të ndryshme dhe natyrisht ata janë nga krahina të ndryshme të viseve shqiptare prej nga janë shpërngulur, por asnjë nga ata nuk ndahet në shoqata a grupime sipas përkatësive të ngushta vendore (lokale), aq më pak duke u ndarë gegët veç dhe toskët veç, **por thjesht si shqiptarë**. Nga pikëpamja gjuhësore *i vetmi standard, që shqiptarët duhet ta mbajnë gjallë është gjuha shqipe e njësuar*, gjuha shqipe e përpunuar dhe në kristalizim e sipër. Ky standard mund të ketë edhe ndonjë gjë për të vështruar, për ta përmirësuar dhe unë nuk kam ndonjë gjë kundër, sepse shkenca ecën përpara, dalin dukuri të reja shoqërore e politike, të cilave gjuha duhet t'u përgjigjet me mjetet e saj ekzistuese ose duke i krijuar me brumin e vet. Kur kjo nuk është e mundur do të marrim edhe hua. Pra, edhe më tej, natyrisht, do të bëhen edhe rishikime dhe përmirësime, por standardi i shqipes është i të njëjtit tip siç janë edhe ai i italishtes, i gjermanishtes apo edhe i popujve të tjerë të qytetëruar, të cilët *mbi një larmi dialektore* (ndonjëherë edhe mbi dy gjuhë të ndryshme, që kanë edhe bashkësi kombëtare të ndryshme, siç është Franca apo shtete të tjera frëngjishtfolëse) kanë zgjedhur atë standard, që kanë, i cili është vendosur mbi një bazë të caktuar e të përligjur historikisht.

Të gjithë shqiptarët, si në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, madje edhe në diasporat arbëreshe e arvanite kanë përqafuar gjuhën standarde, duke pasur një gjuhë të njëjtë të shkruar. Të mos harrojmë se sot jemi në një situatë që flitet shumë për pavarësinë e Kosovës dhe, *duke pasur një gjuhë standarde shqipe*, Kosova i tregon botës se nga pikëpamja zyrtare gjuhën e kanë, por edhe kanë një gjuhë tashmë të përpunuar, të ngritur në normë kombëtare e mbidialektore, që u jep mundësi të plota për ta përdorur atë në ballë të gjerë në veprimtari shtetërore, që mund të shkruhet e të përdoret me dobi edhe në veprimtari artistike, edhe në media. Të gjithë e dimë se në Kosovë sot ka edhe gazetari relativisht të mirë, të shkruar e të folur, me prodhimtari e hapësirë përherë e më të gjerë leximi e dëgjimi, që tregon se gjithandëj shqiptarët po shkojnë me sukses nga dialekti drejt gjuhës së njësuar zyrtare. Nuk ka gjë më të bukur se sa kur takohen në tubime zyrtare kryeministrat e Kosovës dhe të Shqipërisë dhe *ajo që i bashkon është gjuha standarde*, prandaj dhe ata duhet të tregojnë kujdes për zbatimin e saj sa më mirë. Kjo është një gjë shumë bukur e me domethënie të madhe

kombëtare shqiptare.⁶

Nga se rrezikohet më shumë sot gjuha shqipe?

Shqipja po dëmtohet dhe mund të ketë edhe më shumë dukuri të pamira nga gojështhurja dhe mungesa e kujdesit për gjuhën, si dukuri të tranzicionit, që duhet të marrin fund; nga shpërfillja, nga mungesa e kujdesit të organizuar e të drejtuar nga shteti; nga botimet e paredaktuara e të pakorrektuara, si dhe nga një farë ndjenje e përgjithshme nënvlerësimi ndaj saj. Megjithatë kam besim se shqipja do të rrojë e do të përparojë edhe më tej. Gjuhëtarët e studiojnë gjuhën, por ata nuk e krijojnë, e marrin në popull. Shqiptarët janë gjuhëdashës, gjuhëruajtës dhe gjuhëbukur. Por, kjo cilësi e shqipes dhe kjo dhunti e shqiptarëve për ta lëvruar e pasuruar gjuhën e vet, duhet të jetë më shumë në vëmendjen dhe përpjekjet e atyre që drejtojnë gazetarinë e shkruar, që botojnë libra e gazeta, që drejtojnë televizionet publike dhe private dhe, mbi të gjitha, nga ata që hartojnë e botojnë librat shkollorë, që nga abetarja deri te tekstet e monografite shkencore universitare.

Kujdesi për shkrimtarinë digjitale në gjuhën shqipe si një nga pikat e forta të mbrojtjes së shqiptarisë

Në përputhje me zhvillimet e sotme të shqiptarëve është pikërisht koha e duhur të shqyrtojmë mbarëvajtjen e mëtejshme të gjuhës shqipe, si një nga dukuritë më të rëndësishme të shqiptarisë dhe të kombit shqiptar, që na përbashkon e na lidh në një hallkë të fortë etnike e shpirtërore, të hershme e të përhershme, të cilën, sot më tepër se kurrë, **është koha që edhe ta njohim**, edhe ta duam, edhe ta vlerësojmë, po, mbi të gjitha, ta mësojmë e ta ruajmë, natyrisht, edhe duke synuar të mbledhim mendime e vlerësime se si duhet ta mbrojmë, ta pastrojmë e ta pasurojmë me aq sa është e mundshme, qoftë edhe në kohën e ndikimeve dhe trysnive, që i vijnë shqipes dhe shqiptarisë nga rrafshimet evropianizuese e globalizuese.

Theksova se, një tipar shumë i rëndësishëm i gjuhës shqipe, ashtu si edhe i gjuhëve të tjera, është përdorimi i saj në të gjitha

⁶ Shkurtaç.Gj., Urgjenca gjuhësore, Naimi, 2017. Défence de la langue Française, Septembre, 1975, f.4-6.

fushat e ekonomisë. Me digjitalizimin masiv të tregut, ne sot prodhjmë pothuajse dhjetë herë më shumë **shkrimtari digjital në shqip**, sesa prodhohim 20 vjet më parë. Me përhapjen e shpejtë të telefonisë celulare dhe rritjen e shpejtësisë së internetit në këto aparate, gjuhës sa vjen dhe i shtohet trysnia për ta ruajtur, por edhe domosdoshmëria për të ngritur **disa standarde që mund t'i quanim të shqipes digjitale**. Këtu do të thosha se, mbase, na duhet një standard për shqipen e përdorur në menynë e telefonave celulare, që hyjnë në tregun mbarëshqiptar. Gjithashtu një tjetër aspekt është rrethana madhore se sot në botë po pakësohen (për të mos thënë po zhduken) nga qarkullimi librat, dhe janë rritur tashmë **përdorimet e platformave digjitale të leximit** (*Amazon, Apple books* etj.). Porse asnjë nga këto platforma nuk i ofron këto produkte në gjuhën shqipe. Kjo për faktin se për prodhuesit dhe tregtuesit e tyre "shqipja" nuk përbën një treg të fuqishëm. Por, edhe për aq sa janë përdoruesit shqiptarë, nëse do të veprohet ashtu si duhet, nëse do të gjenden drejtimit dhe rrugët e duhura, mund të jetësohet e të gjendet shtegu i duhur. Për këtë, sigurisht, është shumë e rëndësishme të veprohet pa mënuar që, ashtu siç shteti kërkon që barnat (ilaçet), apo paketat e cigareve që sot hyjnë në tregun shqiptar të jenë edhe në gjuhën shqipe, ne të kërkojmë të njëjtën gjë nga prodhuesit e kompjuterëve apo softuerëve (p. sh.: Windows, MAC, etj.). Kjo kërkesë duhet të përbëjë një pikëmbërritje të lakmueshme dhe që duhet realizuar, nëse do të kuptojmë se shqipja nuk është vetëm gjuha që na përbashkon, por ajo është dhe një mjet që e bën hapësirën shqiptare (Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi dhe Maqedoni) një treg solid për tregtimin e produkteve "në shqip". Po të shihet krejt kjo hapësirë shqiptare e shqipfolëse në tërësinë e vet, përfshirë edhe sasinë jo të vogël të shqiptarëve në diasporë, të cilët do të përfshiheshin me kënaqësi në këtë treg digjital shqipfolës, atëherë edhe pesha e vlera e tregut "*made in Albania*" do të dilte me një vlerë të shtuar e të përfillshme.⁽⁷⁾

Pa u zgjatur, do të them se gjendja e sotme e gjuhës shqipe është e tillë: nga njëra anë, në planin absolut e gjeopolitik shqipja dhe shqiptaria janë më mirë se kurrë më parë. Shqiptarët kanë

⁷ Xhuvani A., Për pastërtinë e gjuhës shqipe, Tiranë, 1956; Çabej E., Për pastërtinë e gjuhës shqipe, në "Gjuha jonë", 1, 1981, f.36-47.

shtetet e veta (në Shqipëri e në Kosovë), ose njohje përherë e më të madhe të shqipes në shtetet ku rrojnë në Ballkan (përkatësisht në Republikën e Maqedonisë, në Republikën e Malit të Zi) dhe në diasporat e hershme (arvanite, arbëreshe, arnauete) e të reja (në Evropë, sidomos në Suedi, Zvicër, Gjermani, Austri etj.), ku, gjithashtu, po shtohet njohja dhe pranimi i shqipes si “gjuhë e zemrës” për shqiptarët që janë vendosur si emigrantë të ligjshëm e në bashkësi pak a shumë të përfillshme. Porse, në planin relativ, duhej të ishim më mirë, duhej të kishim treguar më shumë vëmendje, më shumë kujdes e përkushtim për mbrojtjen e shqipes nga fjalët e huaja të panevojshme dhe nga shkeljet e rënda të rregullave të drejtshkrimit e të normave gramatikore. Kemi dhënë shenja të pafalshme të një “kulture të ndërprerë”, sikundër e ka cilësuar me të drejtë një studiuese e përkthyesë e njohur.

Shteti dhe institucionet shtetërore e përgjithësisht publike kanë mbajtur qëndrim të mefshtë e, ndonjëherë, edhe *dukshëm mospërfillës ndaj të shkruarit e të folurit të shqipes në zyrat dhe institucionet botuese*, në gazetatat, revistat dhe në fjalën publike. Ka shpërthyer një farë përtacie e palejueshme dhe dëmprurëse, e cila po shfaqet duke pranuar shkrime, artikuj, fjalime të paredaktuara e të pakorrekтуara nga ana gjuhësore, në të cilat përvidhen jo vetëm gabime drejtshkrimore, po edhe forma morfologjike trashanike, si p.sh.: *me shkopa* (në vend të *shkopinj*), ngatërime kuptimore të fjalëve të zakonshme të shqipes, si *përshkoj e përshkruaj* (p. sh.: *Udha që do të përshkruajë* Papa... në vend të “*Udha që do të përshkojë* Papa...”); *detyrim i mospaguar* (në vend të *i papaguar*); shpesh ngatërrohen foljet *zgjedh* dhe *zgjidh*, duke thënë *ka zgjedhur* (në vend të *ka zgjidhur*) dhe anasjelltas. Jepet emri i një mashkulli dhe thuhet, p. sh.: “*X, Y. është profesore e shquar* (?)” etj. Ka shumë gabime dhe të gabosh, natyrisht, ka qenë dhe mbetet një dukuri normale, por, të mos bësh asnjë përpjekje për t’i shmangur gabimet, **është e pafalshme**.

Kujdes më i madh dhe punë me përkushtim kërkohet edhe për njohjen dhe zbatimin e rregullave drejtshkrimore e gramatikore të shqipes. Ditë për ditë e natë për natë, në gojën e njerëzve të mediave dëgjojmë të thuhet: *hapat e para, me hapa të shpejta në vend të hapat e parë, me hapa të shpejtë*. E njëjta gjë edhe me shumësin e fjalës objektiv: thuhet gabimisht: *këto objektiva, objektiva të mëdha*, në vend të *këta objektiva, objektiva të mëdhenj*. Emrat

hap-i, objektiv-i janë emra të gjinisë mashkullore dhe shumësin e bëjnë normalisht me *-a*, por pa e ndërruar gjininë, njësoj si *burri-i*, shumësin *burra*, *-t* dhe thuhet *burra të mirë* (jo *burra të mira*). Dikush shkruan *idea* (në vend të *ideja*), dikush shkruan *e diele, e djelë* (në vend të formës së drejtë *e diel*) dhe, për turp e dëm të madh, deri fjalë tashmë të stërpërdorshme si: *tradhtar, tregtar, tregti* në botimet e sotme shkruhen gabim (*tradhëtar, tregëtar, tregëti*). Po shtohen si këpurdhat mbas shiut edhe format jonormative në foljet më të përdorshme, si *shkrojta në vend të shkrova*, madje, ndonjëherë edhe *shkruajta* e *shkruva*, që mund t’u faleshin vetëm fëmijëve të moshës së njomë, që ende nuk e kanë nxënë shqipen.⁸

Shqetësimi bëhet edhe më i madh, kur bindemi se kjo ndodh jo vetëm nga padija, nga mosnjohja e normës, por më tepër nga pakujdesia, nga mospërfillja e rregullave dhe e normave të shqipes standarde, nga mbivlerësimi i së huajës dhe nga nënvlerësimi (ndoshta edhe përçmimi) i kulturës kombëtare në përgjithësi.

Në shkollat e sistemit parauniversitar, po edhe në universitetet tona, ka edhe pedagogë e asistentë, që nuk i japin rëndësinë e kujdesin e duhur gjuhës shqipe, nuk japin shembullin e vet personal para studentëve në zbatimin e rregullave të drejtshkrimit si dhe bien në shkelje të pafalshme të normave gramatikore të shqipes, për të mos folur për rendjen pas fjalëve të huaja të panevojshme.

Ndaj kësaj mënyre të shkruari e të foluri ne kemi reaguar e jemi shprehur, por *duhet të bëjmë më shumë e më me përkushtim*, në mënyrë që të arrihet që fakultetet filologjike, si balli i luftës për ruajtjen dhe pastrimin e shqipes, të japin edhe shembullin më tëmadh. Këtu, natyrisht, është e nevojshme të marrin pjesë e të veprojnë jo vetëm gjuhëtarët, po edhe të gjithë mësuesit e pedagogët në përgjithësi.

Kemi probleme me mosrespektimin e alfabetit të shqipes, duke marrë gati si të mirëqenë të shkruarit e *ë-së* si *e*. Sot, te shumica e dokumenteve shtetërore si dhe në shkrimet në gazeta, revista e libra, në masë të gjerë nuk shkruhet *ë-ja*. Në vend të saj kudo ka vetëm *e: eshte, bera, bejme* etj.

⁸ Shkurtaj Gj., Pjesë nga fjala hyrëse e Tryezës “Sfidat e shqipes sot”, mbajtur më 21 shkurt, në ditën ndërkombëtare të gjuhëve amtare, në Kryeministrinë e Republikës së Shqipërisë, të organizuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Po ashtu janë shtuar shtrembërimet trashanike të trajtave të fjalëve, ngatërime të gjinisë së emrave dhe sidomos moslakimi i emrave të përveçëm të huaj ose të huazuar në shqipen. P. sh. thuhet: “*Kanë vvarë Ordëll*” (në vend të ...*Ordëllin*). “*Do të shkosh tek Ordëll*” (në vend të ...*tek Ordëlli*). “Nesër **takimi i Trump me Jelcin**” (në vend të ... *i Trampit me Jelcinin*) etj.

Politikanët dhe shtetarët shqiptarë, pas tyre edhe disa gazetarë, e kanë si “tregues të diturisë” së tyre përdorimin e fjalëve të huaja “nga malli” e jo nga halli. Më të zellshmit për fjalë të huaja nga “malli” janë ata që shkruajnë reklamën dhe spotet e televizioneve, si dhe politika e media, prej të cilëve nuk po na ndahen përdorime të tilla. Shikoni me sa “dashuri” e kanë marrë këto ditë deputetët termin “inçenerator”, kur fjala është për një lloj furre për djegien e letrave dhe mbeturinave. Edhe më të rënda apo vërtet skandaloze janë rastet kur funksionarë e shtetarë të ndryshëm përdorin fjalë e terma të huaj, të cilat i ngatërrojnë dhe i përdorin në vend të fjalëve të duhura tjetër për tjetër, si p. sh. *evazion fiskal* e kemi dëgjuar disa herë edhe në formën *invazion fiskal*; *kontator elektrik* një nëpunës e thoshte *konduktor*. I shkreti, sa mirë do të shpëtonte nga një siklet i tillë, po të thoshte shqip *matës elektrik*, *matës i energjisë*.

Problemet që dalin: Së pari, kemi qenë e do të jemi patjetër të hapur e pranues ndaj asaj që vjen nga jashtë si e domosdoshme, por jo duke e prishur shqipen dhe, mbi të gjitha, kur fjalët dhe termat e huaj janë krejt të panevojshëm si rasti *vakant* e *vakancë* dhe gjithë ajo plojë fjalësh të huaja, shpesh edhe të pakuptueshme për më shumë se tri të katërtat e shqiptarëve me të cilën “kanë rënë në dashuri” shtetarët tanë, që nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë e deri te Kuvendi i Shqipërisë që shkruajnë **është vend pune vakant dhe vakantë**, kur fjala është për *vende pune të lira*, *vende punë të pazëna*, *vende pune të liruara*, për arsye të daljes në pension ose largimit të dikujt që ishte më parë në atë vend.

Me shqetësimin e ligjshëm se pse po teprohet me këtë dënduri bombardimesh me *vakant* e *vakancë*, kam parë këto ditë fjalorët dygjuhësh anglisht-shqip, frëngjisht-shqip, italisht-shqip dhe disa të tjerë. Në të gjithë, pa asnjë përjashtim, fjala *vakant* **përkthehet me fjalën shqipe i lirë**, ose me dysorë të tij të shqipes popullore *bosh* dhe *i zbrazët*, kurse *vakancë*, – a ka si kuptim të **përgjithshëm**

pushimet e shkollave, pushimet e gjykatave.

Në Fjalorin italisht-shqip të Ferdinand Lekës e Zef Simonit, që mbahet si më i miri i hartuar deri sot, fjala *vacanza* ka si kuptim të parë në shqip *vend i lirë* dhe si kuptim të dytë *pushim*, kurse togfjalëshi *fare vacanza* përkthehet *bëj pushim, rri pa punë; vacanze përkthehet pushim vjetor, leje vjetore; vacanze estive përkthehet pushime verore, vacanze al mare përkthehet pushime buzë detit.*

Edhe folja *vacare në shqipen në atë Fjalor* përkthehet me **është i lirë, është i pazënë** dhe si kuptim të tretë ka ***nuk është më në fuqi.***

Na duket me vend që, së pari, të ritheksojmë shpjegimin se fjalët *vakant e vakancë* nuk kanë pse përdoren në shqipen, sepse shqipja ka fjalët e veta të plotvlershme që mund të përdoren për të treguar vendet e punës që *janë të lira, të pazëna ose të liruara*, duke thënë, përkatësisht: *vend pune i lirë ose vend i lirë; vend pune i pazënë ose vend i pazënë* dhe, me shumë plotvlershmëri, mund të thuhet edhe *vend pune i liruuar ose vend i liruuar.*

Së dyti, po edhe më për së forti, e ndiejmë të domosdoshme të sjellim në vëmendjen e shtetarëve tanë, qofshin punonjës të thjeshtë të zyrave ku formulohen shkresat e ligjet, qoftë të ministrive e deri të Kuvendit të Shqipërisë, ku miratohen ligjet, të heqin dorë nga kjo mospërfillje e palejueshme e rregullave dhe e normave të shqipes, duke mos rendur pa nevojë mbas fjalëve e termave të huaj, kur gjuha shqipe i ka të vetat ose mund të krijohen me brumin e saj.

A e shihni (dëgjoni) edhe ju, kolegë e miq të nderuar, se çfarë trysnie e pamirë po i bëhet shqipes nga fjalët e huaja të panevojshme?! Dhe, po për arsye historike, nuk mund të rri pa përmendur kujdesin e treguar për pastërtinë e gjuhës shqipe qysh në fillesat e jetës së shtetit të parë shqiptar të kryesuar nga Ismail Qemali. Në vitin 1913, Ndre Mjeda, në cilësinë e deputetit të Shkodrës kërkonte që të thuhej shqip ***rendi i ditës*** dhe jo ***urdhri i ditës***, si togfjalësh i kalkuar nga italishtja *ordine del giorno* apo frëngjishtja *ordre de jour*. Dhe, madje, Mjeda kërkonte që t'i kushtohet kujdes deri edhe fjalëve të ahengut shkodran. Kurse Kuvendi ynë na mbyti me fjalë e terma të huaj, si ***vetingu që na e mori frymën***, po edhe që shumica e deputetëve dhe mbarë populli i thjeshtë nuk ia dinë as kuptimin. Po ta vrisnin mendjen

sadopak shtetarët dhe njerëzit që merren me ligjet e me gjyqësorin në përgjithësi, do ta kishin gjetur edhe një fjalë të bukur e të përshtatshme shqipe për vetingun sikundër e ka gjetur një poet, nga Kosova, i cili pikërisht për atë term të pakuptueshëm, sjell nga gjuha e popullit fjalën *peshore*, një fjalë sa të thjeshtë aq edhe domethënëse:

*Se njeriu në këtë botë
Një herë hipën në peshojë
Ai mat shumëçka supeve përmbi
Të mos i bjerë haku në peshoren e tij.* ⁽⁹⁾

Burimet dhe rrugët e këtij pasurimi kanë qenë e mbeten edhe më tej: krijimi i fjalëve dhe i termave të rinj nga brumi vetjak, fisnikërimi i fjalëve të bukura dialektore e popullore, qoftë nga Jugu, qoftë nga Veriu. Një kujdes e përfillje më e madhe i takon në ditët tona njohjes më të mirë dhe mbajtjes gjallë të shpirtit kombëtar të shqipes, që shprehet në atë që ne e kemi quajtur *“etnografi e të folurit të shqipes”* dhe që, në thelb, do të thotë të sjellim sa më gjerë timbret dhe vlerat intonacionore të popullit; të pranojmë edhe kalket gjuhësore, kur nuk mjaftojnë fjalët e frazeologjizmat e shqipes, si dhe të jemi të hapur ndaj fjalëve e termave të huaj të domosdoshëm, por, siç e thekson me të drejtë përkthyesi i mirënjohur Edmond Tupja, duke u dhënë pas së huajës “biem në kurth” të kalkeve pa nevojë. Në çdo rast, duke pasur parasysh thënien urtake të popullit tonë dhe thirrjen e pavjetërsueshme të Naimit: *“Shqip të flasim përherë, thjesht e pa përzier”*.

Pa dyshim se, në kumtimet e sotme, duke iu përmbajtur disa pikave, që janë nxjerrë si më kryesore në qerthullin e dukurive, që na shqetësojnë, uroj që, secili mësime dhënë i shqipes, përkthyes, drejtues i mediave apo i botimeve, mund të japë ndihmesën e vet për të pasur një pamje sa më të qartë, po edhe sa më të arsyetuar të gjendjes, po edhe të sfidave të shqipes në ditët tona.

Ajo që mëtojmë të shqyrtojmë ne në këtë tryezë të rrumbullakët, nuk është as e re, as e panjohur, as e pazbatueshme. Edhe në vendet e kombet temëdha të Evropës, bëhet kujdes për ruajtjen e gjuhës. Këtu po përmendim, vetëm një rast, nga shumë të tjerë: qëndrimin pohues, mbrojtës e qartësisht të shpallur që mban Franca për

⁹ Flamur Shala, Gjeniu, Prishtinë, 2016, f. 64

gjuhën e vet. Si shembull mund të sjellim një prej raporteve të fundit të “Défense de la langue française” (2017) për parlamentin francez, ku jepet vlerësimi zyrtar i gjuhës frënge si “*pilier de notre culture, est un ciment de notre société*” dhe i detyrimeve dhe masave që Ministria e Kulturës i drejton parlamentit francez.

Edhe tubimi me temë “Sfidat e shqipes sot”, që u zhvillua në ditën e gjuhës amtare, i ideuar dhe i organizuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, mendoj se ishte i kohës, i rëndësishëm dhe që kërkon të sjellë në vëmendjen tonë, po edhe të të gjithë shqiptarëve, të njerëzve të thjeshtë dhe të atyre që drejtojnë shtetin (përkatësisht shtetet), të institucioneve arsimore, kulturore, botuese dhe medias zyrtare, publike dhe private vlerësimin dhe kujdesin e vazhdueshëm për gjuhën shqipe”.

Një pjesë e mirë e diskutimeve iu kushtuan gjuhës në administratën shtetërore dhe në botimet e institucioneve publike dhe jopublike me karakter zyrtar, duke kërkuar që aty të ketë kërkesa të rrepta për zbatimin pa shmangie të rregullave të drejtshkrimit e të normave të shqipes së njësuar. Kjo të bëhet me qëllim që ato të bëhen të njohura e t’i vlejné shqyrtimit të mëtejshëm të disa dukurive të shqipes së sotme, me karakter mirëfilli studimor, ose thjesht normativizues. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje mori përsipër që diskutuesit t’i nisin me e-mail kumtimet e tyre të plota dhe ato do të botohen në një broshurë të veçantë.

Bibliografia:

- Ajeti I. *Mjetet e informimit për ngritjen e kulturës gjuhësore*, në “Çështje të kulturës së gjuhës”, Prishtinë, 1980, f.15; Raka F. *Çështje të shqipes letrare*, Shkup, 1998.
- Çeliku M., *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë, 2001; Islamaj Sh., *Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i gjuhës*, Prishtinë, 2002.
- Shkurtaç Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës*, Kristalina KH, Tiranë, 2003; *Si të shkruajmë shqip-Baza të shkrimit akademik*, Botimet Morava, 2013.
- Strunk Wiliam, Jr., *The Elements od Style*, New York, 1918.

- Shkurtaj.Gj., *Urgjenca gjuhësore*, Naimi, 2017. *Défence de la langue Française*, Septembre, 1975, f.4-6.
- Xhuvani A., *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956; Çabej E., *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, në “Gjuha jonë”, 1, 1981, f.36-47.
- Shkurtaj Gj., Pjesë nga fjala hyrëse e Tryezës “Sfidat e shqipes sot”, mbajtur më 21 shkurt, në ditën ndërkombëtare të gjuhëve amtare, në Kryeministrinë e Republikës së Shqipërisë, të organizuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.